



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 443/5 Prot.

Tiranë, më 05.03 2025

V E N D I M

Nr. 36 dt. 05.03 2025

“PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VERIFIKIMIN E GJETJEVE TË RAPORTIT TË
M.A.S. PËR PROCESIN E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË
PROGRAMIN E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË “SHKENCA SPORTIVE” NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES

Mbështetur në nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, në nenin 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, në Raportin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 5316/4 Prot. datë 27.12.2024 dhe shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 539/1 Prot. datë 13.02.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.03.2025,

VENDOSI:

1. Ngritjen e grupit të punës për verifikimin e gjetjeve të Raportit të MAS nr. 5316/4 Prot. datë 27.12.2024, për programin e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Shkenca Sportive”, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes.
2. Grupi i Punës përbëhet nga:
 - Prof. Dr. Dhurata Bozo -Kryetare
 - Prof.Asc.Dr. Klotilda Vrenjo -Anëtare
 - Dr. Aisel Oseku -Anëtare
3. Grupit të Punës t’i vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni zyrtar i nevojshëm për kryerjen e këtij procesi.
4. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Zyrës së Arkiv-Protokollit, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

